

JEMI VULLNETARË



PËR TË MIRËN E TË GJITHËVE

TË BARABARTË NË DEMOKRACI

ARLIND (10), ENIS (11), ANTEA (10), DIELLZA (11), SIAM (10), MAIDA (10), FJOLLA (10)




Vetëm kështu dëshirojmë ta shohim Kosovën. Të bukur, të pastër, të ndërtuar dhe me qytetarë të lumtur

E ardhmja e vendit jemi ne fëmijët. Të drejtat tona si fëmijë na mundësojnë neve që të kemi një jetë me plot lumturi dhe harmoni

Në lagjen tonë, shumë shpesh mbledhemi të gjithë fëmijët dhe luajmë lirshëm. Zakonisht lojërat që i pëlqejmë më shumë janë: futboll, volejboli, mes dy zjarresh, modelesh, apo edhe lojëra të tjera. Si fëmijë që jemi ne e kemi të drejtën e lojës, si dhe të drejtën që të zgjedhim lojën që e pëlqejmë. Përveç këtyre të drejtave, ne gjithashtu gëzojmë edhe të drejtën e shkollimit, të drejtën e familjes, të drejtën e strehimit, të drejtën e kujdesit shëndetësor, të drejtën që të shprehim mendimet tona, etj. Këto të drejta i kemi të garantuara me ligje të ndryshme, sepse ne jetojmë në një vend demokratik. Por, çfarë do të thotë kjo? Demokracia është udhëheqje nga populli dhe për po-

pullin. Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja e vjetër, ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ do të thotë udhëheqje. Barazia dhe liria janë elemente shumë të rëndësishme në demokraci. Grupi ynë sot diskutoi më shumë rreth demokracisë. Por, njëkohësisht ne edhe i zbatuam elementet e demokracisë. Gjatë punës sonë, secili nga ne kishim role të ndryshme, por gjatë gjithë kohës nuk harruam që të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin. E bashkëpunimi dhe respekti për të tjerët është një ndër elementet më qenësore të demokracisë. Pra, nga kjo mund të kuptojmë se është shumë e rëndësishme që të mësojmë gjëra, por edhe t'i zbatojmë ato në jetën e përditshme. Ne jemi të lirë, por edhe kemi respekt të sinqertë për njëri-tjetrin. Për tema të tjera të lidhura me demokracinë, vazhdoni leximin tuaj.



Barazia në demokraci, pa dallim gjinie



„ 7 Zogjtë Pranverorë“

VOTA ËSHTË VULA E DREJTËSISË DHE BARAZISË

ELMIR (10), ENI (10), ARIAN (10), ALMEDINA (10), VLERA (10), DIORA (10), DREN (10), ERON (11)



A keni menduar se edhe demokracia ka zemër sikur njeriu? Është pikërisht ajo zemër e cila i jep jetë dhe emocion sistemit demokratik të qeverisjes. E zemra e demokracisë është vota

Për të përshkruar sa më mirë zgjedhjet, ne përdorëm fjalën zemër. Kjo sepse ne duam që edhe ju ta kuptoni se procesi zgjedhor dhe votat kanë vlerë të jashtëzakonshme. Në procesin e votimit, secili është i barabartë me tjetrin. Kjo po që është drejtësi. Të drejtën



për të votuar për shtetin tonë e fitojmë që nga moshë 18 vjeçare, sepse ligji e ka përcaktuar kështu dhe ne përfillim të gjitha ligjet. Kjo nuk nënkupton që ne nuk mund ta shfrytëzojmë të drejtën e votimit para kësaj moshë, sepse ne tashmë kemi pasur rastin të votojmë dhe të zgjedhim kryetarin e klasës. Përveç që kemi pasur të drejtë të votojmë, ne kemi pasur mundësinë që edhe vetë të jemi të votuar nga të tjerët. Kjo ka ndikuar që ne të jemi të lirë për të zgjedhur atë të cilët

duam dhe të cilët do të na përfaqësojnë denjësisht. Ne duam që t'iu sfidojmë me një pyetje, juve lexues të dashur. Si mendoni a ka më shumë peshë vota e një ish-Presidenti apo vota e një edukatori/eje?


Fillimisht ju mund të mendoni që vota e një ish-Presidenti ka vlerë dhe peshë më të madhe. Por, ne iu njoftojmë se kjo nuk qëndron kështu. Para procesit të votimit të gjithë jemi njësoj dhe vota ka po të njëjtën rëndësi, pa marrë parasysh se nga kush është dhënë ajo. Andaj, me plot vendosmëri themi se vota është vula e drejtësisë dhe barazisë. Atë duhet gjithmonë ta shohim si të shenjtë dhe të çmuar. E nëse themi se vetëm një votë bën ndryshimin, atëherë dije se pikërisht ti që je duke e lexuar këtë artikull mund të jesh ai ose ajo që vendos për ndryshimin e nevojshëm dhe të dëshiruar në vend. Dora jote magjike mund ta jap vulën e ndryshimit për të gjithë ne. Ndjeju krenar për këtë.



Margaritarët demokratikë

AKTIV NË DEMOKRACI

ALDA (11), VALENCJA (11), MELODI (11), ELONA (11), DION (11), DIOR (10), FLORENT (11), ORGES (10)



Demokracia pa qytetarët nuk mund të ekzistojë. Mirëpo, nëse nuk do të kishte demokraci qytetarët do të jetonin pa të drejta. Kjo lidhje mes qytetarëve dhe demokracisë nuk shkëputet asnjëherë

Një ditë, ne nxënësit e klasës sonë vendosëm të bënim diçka të dobishme dhe t'iu ndihmonim të tjerëve. Kështu, pas shumë diskutimesh u dakorduam që të mbledhim dhurata dhe t'ua dërgojmë fëmijëve me nevoja të veçanta. Në këto dhurata përfshiheshin: lapsa, goma, libra dhe fletore. Ne menduam se edhe ata e vlerësojnë shkollën po aq sa ne, si dhe do të gëzohen pasi ta kuptojnë që iu kemi dërguar mjete shkollore. Dhe vërtet kështu ndodhi. Ata u gëzuan pamasë. Edhe ne ishim shumë të gëzuar. Ta bëje dikë tjetër të lumtur ishte ndjenjë vërtet e bukur.

Ne nuk u ndalëm me kaq. Një ditë tjetër pastruam oborrin tonë të shkollës duke mbledhur të gjitha mbe-

turinat. Pas saj, ne u ndjemë krenarë me veten tonë. Edhe të tjerët ishin krenarë me neve, sepse u aktivizuar për të bërë diçka të mirë për komunitetin tonë. Ah, po! Unë dhe shokët e mi kemi pastruar edhe lagjen tonë. Në këtë mënyrë në lagjen tonë mund të thithësh vetëm ajër të pastër. Kështu u ka hije qytetarëve. Ata duhet të jenë aktiv dhe gjithmonë të angazhuar. Nëse jeni në dilemë se si mund të jeni edhe ju aktiv, e kemi ne një ide për ju. Të gjithë kemi rroba, të cilat për arsye të ndryshme nuk i përdorim më. Këto rroba mund t'i mbledhni dhe t'i fusni në kuti. Atë kuti merreni dhe dërgojeni te dikush që ka nevojë për to. Kështu, ju edhe mund të formoni edhe një lloj shoqate, ku të gjithë personat që kanë rroba që nuk i përdorin më mund t'i sjellin tek ju. Më pas, ju i shpërndani ato rroba tek personat ne nevojë.

Ja sa e thjeshtë është të ndryshosh për të mirë shoqërinë!



Gjatë punës sonë si gazetarë




Ne, autorët e këtij artikulli

Në këtë pjesë të artikullit tonë do t'iu tregojmë disa mënyra të tjera se si mund të jemi aktiv. Aktivizimi ynë në shtetin tonë është i domosdoshëm nëse duam të kemi demokraci të qëndrueshme

Çdo angazhim i yni për të përmirësuar vendin ku ne jetojmë, na bën neve qytetarë aktiv. Ja edhe disa mënyra të tjera se si të jemi aktiv: të marrim pjesë në tubime publike, të votojmë në procesin zgjedhor, të nënshkruajmë peticione, etj.

Vendi ynë Kosova është një vend i bukur dhe ne si qytetarë demokratik kemi shumë të drejta. Disa nga të drejtat tona vetëm sa i keni lexuar në artikullin e faqes 3. Por, ajo çfarë ne dëshirojmë të potencojmë është se këto të drejta i gëzojmë të gjithë, pa asnjë lloj dallimi. Megjithatë, nuk duhet të harrojmë se ne kemi edhe përgjegjësi ndaj vendit tonë. Këto përgjegjësi na takojnë neve si qytetarë. Numërojmë disa prej tyre: respektimi i ligj dhe njëri-tjetrit, pagesa e taksave, ruajtja e ambientit dhe pronave publike, pjesëmarrja në zgjedhje, etj. Mbajeni në mend se për një demokraci të plotë dhe shtet të mirë, duhet ne qytetarët të jemi sa më aktiv.



Jemi të ndryshëm, por të bashkuar e rrisim demokracinë



Mbeturinat gjithmonë i vendosim në vendin e tyre

Tung,
lexues i kësaj gazete.
Emri im është Fatmir dhe unë
i kam disa këshilla për ty. Bëhu
qytetar aktiv dhe duaje vendin tënd.
Ti ke shumë të drejta dhe je i lirë
t'i përdorësh ato.

Mirëpo,
mos harro se gjithmonë
duhet të respektosh edhe të drejtat
e të tjerëve. Nëse ka diçka që nuk të
pëlqen në lagjen apo qytetin tënd, atëherë bëj
të pamundurën që ai problem të rregullohet.
Ndihmoju të gjithëve sa herë që ke
mundësi. Ne e bëjmë demokracinë,
unë dhe ti!

Dëgjoni këshillat e Fatmirit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dardania“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Pejë